



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Bushati takon Kurz: Nisja e bisedimeve për anëtarësim, fillimi i rrugëtimit evropian të Shqipërisë

2017-12-07 18:40:00



Në kuadër të ministerialit të OSBE-së, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati zhvilloi një takim me Ministrin për Evropën, Integrimin dhe Punët e Jashtme, njëkohësisht Kancelar i zgjedhur i Austrisë, Sebastian Kurz.

Biseda u përqëndrua tek perspektiva evropiane e Shqipërisë, duke pasur parasysh se Austria ka presidencën BE-së vitin e ardhshëm. Ministrat diskutuan gjithashtu për çështje të bashkëpunimit dypalësh dhe bashkëpunimin ekonomik. Bashkëbiseduesit u ndalën dhe tek aktivitetet e përbashkëta në kuadër të vitit kulturor Shqipëri-Austri 2018.

Ministri Bushati e njohu Kurz me reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare duke u ndalur sidomos tek reforma në drejtësi dhe procesi i vettingut. Ai u shpreh se Shqipëria e shikon nisjen e bisedimeve për anëtarësim si fillimin e rrugëtimit evropian të vendit.